

## ABSTRAKT

Organizatave kriminale janë grupe të strukturuar që merren me aktivitete të paligjshme për të fituar pushtet dhe pasuri. Ato operojnë nëpërmjet rrjeteve të fshehta dhe shpesh përfshijnë në veprimtaritë e tyre korrupsionin, trafikimin e njerëzve, drogës dhe armëve, si dhe pastrimin e parave. Ndër organizatat kriminale më të njohura në mbarë botën janë organizatat kriminale italiane si Mafia Siciliane, Ndrangheta, dhe Camorra të cilat kanë ndikim në jetën politike dhe ekonomike italiane, duke sfiduar autoritetet ligjore dhe duke krijuar një kulturë të frikës dhe heshtjes tek populli. Kto organizata janë të përfshira në aktivitete të ndryshme kriminale të cilat shkaktojnë prishjen e sistemeve financiare, terrorizëm, dhe shumë aktivitete të tjera.

Qëllimi i këtij hulumtimi është i fokusuar në analizimin e funksionimit të organizatave kriminale në shoqërinë bashkëkohore, me theks të veçantë funksionimi i organizatave kriminale italiane si dhe masat për parandalimin dhe luftimin e tyre të zbatuara nga autoritetet italiane. Përmes këtij hulumtimi është identifikuar ngjashmëria dhe dallimet e organizatave kriminale, struktura organizative si dhe aktivitetet kriminale të tyre. Poashtu është arritur në përfundim se shteti italian ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në hartimin e infrastrukturës ligjore dhe në zbatimin e saj me qëllim të luftimit të organizatave kriminale.

Fjalët kyçe: organizatat kriminale italiane, aktivitet kriminal, parandalimi, luftimi.